Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

01/Nr.9506/2026
Data: 14.10.2026

PROCESVERBALI I KOMITETITPËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e nëntë -IX- për vitin 2026 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më datë 21.09.2026, me fillim pune në orën 11:00, në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Sevdi Dernjani (Nënkryetar i Komunës), Abduraman Bushi (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Lindita Ballazhi (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), Hisni Luri (Drejtor për Arsim), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Sear Dernjani (Shef i Arsimit), Amir Bushi (Udhëheqës i Qendrës për Punës Sociale), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
2. **Buxheti i komunës për vitin 2027 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2028-2029.**
3. **Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2027.**
4. **Rishqyrtimi i vendimit me numër 01/Nr.6383/2026 për ofertën e përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.**
5. **Draft plani komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Hanit të Elezit 2026-2028.**
6. **Informatë mbi fillimin e vitit shkollor 2026/2027.**
7. **Të ndryshme.**

Kryesuesi thekson: Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim rendin e punës. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Buxheti i komunës për vitin 2027 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2028-2029.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti i komunës për vitin 2027-2029 mbështete në grantet qeveritare të cilat përfshijnë mbi 89 % të buxhetit dhe 10.6 % nga të hyrat vetanake komunale, ndërsa në total është 4,654,793.00 € duke i përfshirë këto kategori për Pagat dhe shtesat 2,851,812.00 € apo 61.2%, Mallrat dhe shërbimet 568,527.00 € apo 12.2 %, Shpenzimet komunale 111,000.00 € apo 2.4 %, Subvencionet dhe transferet 215,000.00 € apo 4.6 % , Shpenzimet kapitale 908,454.00 € apo 19.5 % . Buxheti është shpërndarë nëpër kategori buxhetore si dhe nënprogramet buxhetore , është bërë shpërndarja në bazë të programeve buxhetore . Dokumentet që është mbështetur ky proces është korniza afat mesme buxhetore e cila është miratuar në qershor të vitit 2026, qarkorja e parë dhe e dytë buxhetore , plani zhvillimorë dhe urbanistikë i komunës , lista e projekteve kapitale siç është pranuar nga qytetarët nga debatet buxhetore. Në debatin të cilin e kemi mbajt për buxhetin për vitin 2027-2029 nuk kemi pranuar kërkesa prej qytetarëve dhe ata të cilët janë propozuar për kornizën buxhetore të cilat janë në kompetencë të komunës janë pranuar dhe janë përfshirë në buxhetin total komunal.

Nexhmedin Daci thekson: në kuadër të projekteve kapitale propozoj që të futet projekti Gorancë - Krivenik në shumë prej 11 000 €.

Visar Hasllari thekson: kërkoj sqarim për projektin Hani tre dejë. Çështjen tjetër që e kam ngritur është pastrimi i prrockës në Lagje të re për të cilën keni potencuar që nuk hynë në kuadër të projekteve kapitale dhe a planifikohet për këtë vit.

Nexhmedin Daci thekson: sot drejtoresha e financave më njoftojë që Ministria e ka miratuar vendimin për rialokimin e mjeteve dhe nuk e di sa mjete financiare janë për mallra dhe shërbime dhe nëse ka mjete financiare kryhet në këtë vit por nëse nuk ka mbetet për vitin e ardhshëm. Sa i përket Hanit tre de është ideja për Hanin e Moqëm me dizajnuar.

Visar Hasllari thekson: te drejtoria për shërbime kam kërkuar sqarim për vlerën e mjeteve që është para parë për blerjen e një kamioni multifunkisonal. Është mirë me na sqaruar se si do të i bartet kompanisë Pastrimi.

Nexhmedin Daci thekson: sa i përket kamionit nëse arrihet që të blehet është puna ma e mirë që do të bëhet sepse komuna nuk ka kapacitete me i mirëmbajtur rrugët dhe shuma e mjeteve prej 135 000 € nuk mjafton dhe me siguri duhet me shtuar më shumë mjete financiare.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2027 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2028-2029 QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

3. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2027.

Kryesuesi thekson: është i njëjti plan sikur i vitit të kaluar dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parshtroni.

Lindita Ballazhi thekson: kërkoj që bartja e bilancit të pashpenzuar të bartet nga muaji shkurt për në muajin majë.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

4. Rishqyrtimi i vendimit me numër 01/Nr.6383/2026 për ofertën e përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka kthyer në rishqyrtim vendimin për dhënien në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme të komunës se siç kanë potencuar ata është dashur të shënohet vendim përfundimtarë , ndërsa shënon vetëm vendim . Mu ka dukur e pa arsyeshme dhe në përmbajtje nuk kanë dhënë asnjë vërejtje.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RYSHQYRTIMI I VENDIMIT ME NUMËR 01/NR 6383 /2026 PËR OFERTËN E PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

5. Draft plani komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Hanit të Elezit 2026-2028.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Amir Bushi thekson: plani është unik për tërë Kosovën dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU DRAFT PLANI KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E QNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRIMINE TË HUAJVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

6. Informatë mbi fillimin e vitit shkollor 2026/2027.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sear Dernjani thekson: fillimi i vit shkollorë ka filluar sipas kalendarit të vitit shkollorë të Ministrisë së Arsimit dhe të gjitha shkollat i kanë bërë përgatitjet e duhura, të gjithë nxënësit janë pajisur me tekste shkollore por ka pasur disa familje të cilat nuk kanë pasur çasje në sistemin E-Kosova por në bashkëpunim me librarinë Dukagjini i kemi furnizuar ata nxënës për shkak se nuk kanë pasur mundësi tjetër. Në këtë vit janë minus katërdhjetë e tre nxënës më pak. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Visar Hasllari thekson: në disa portale e kam pa që ka pasur problem me çështjen e transportit, a mundeni me na informuar më shumë rreth kësaj çështje.

Sear Dernjani thekson: tenderi është shpallur për këtë çështje por sipas procedurave të prokurimit kompanitë nuk kanë qenë të pajisura me dokumentacion dhe pas zhvillimit të procedurave është shpallur fituesë kompania.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI FILLIMIN E VITIT SHKOLLOR 2026/2027 QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: A keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:37.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta